

FTESË PËR OFERTË

Ref no: T-0012-04-2010

ProCredit Bank, banka më e suksesshme në Kosovë i fton të gjitha kompanitë e specializuara dhe të interesuara për :

Furnizim me karburant për automjete, gjeneratorë dhe nxehe qendrore për t'i plotësuar nevojat e ProCredit Bank-ës në Kosovë.

Të interesuarit mund ti marrin dokumentet për aplikim nga data 28 Prill 2010 në ProCredit Bank – Zyra Qendrore Bulevardi Nëna Terezë Nr.16 - Prishtinë.

Vërejtje:

- ProCredit Bank është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e ofruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së, ndërsa ofertuesit që nuk janë deklarues të TVSH-së (bëjnë shitje të përjashtuar nga TVSH-ja), nuk duhet të listojnë ndarazi vlerën e TVSH-së.
- Për çmimet të cilat nuk e kanë të listuar TVSH-në ndarazi, do të nënkuptohet se vlera e TVSH-së është e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë dy muaj (60 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen në Euro(€).
- Ofertuesi duhet të ketë përvojë minimum 3 vjeçare në kryerjen e shërbimeve të lartshënuara.
- Dëshmi për pajisjet dhe logjistikën e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të tilla.
- Asnjë shpenzim që e bëni gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të ju kompensohet.
- ProCredit Bank ka të drejtë të anulojë tenderin dhe/ose ndryshojë karakteristikat e tenderit dhe ti ftojë pjesëmarrësit që ti sjellin sërish ofertat e tyre.

Data e fundit për dorëzimin e ofertës së kompletuar është 11 Maj 2010, ora 17:00h.

Oferta në zarf të mbyllur dhe e shënuar qartë „Ofertë për furnizim me karburant“ duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të ProCredit Bank-ës (Bulevardi Nëna Terezë Nr. 16).

ÇDO PYETJE SHITESË RRETH KËSAJ FTESE PËR OFERTË MUND TA ADRESONI NË:

procurement@procreditbank-kos.com